



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2023:054359  
Datë: 15.01.2024  
Numri i dokumentit: 05190833

**PA1.nr.1129/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi, si procesmbajtës në lëndën penale ndaj të akuzuarve R.S., M.P., D.D., G.D., S.P., D.S. dhe Ç.L., që të gjithë nga Shtërpca, për shkak të veprave penale Tregtia e ndaluar nga neni 299 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, për të vendosur sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit Ç.L., av.Kemajl Ademaj, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, me numër të lëndës 2023:074319 të datës 16.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 08.Janar. 2023 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit Ç.L., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, me numër të lëndës 2023:074319 të datës 16.06.2023, **VËRTETOHET**

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, me numër të lëndës 2023:074319 të datës 16.06.2023, të akuzuarit R.S. M.P., D.D., G.D., S.P., D.S. dhe Ç.L. janë shpallur fajtor për shkak të veprave penale Tregtia e ndaluar nga neni 299 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, për të cilën të akuzuarve R.S., M.P., D.D. dhe G.D., iu është shqiptuar dënimi me gjobë secilit veç e veç në shumë prej nga 200 (dyqind) euro e te cilat gjoba janë te obliguar që t'i paguajnë në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë se ketij aktgjykimi si dhe dënimet me burgim secilit veç e veç në kohëzgjatje prej nga 7 (shtatë) muajve me kusht se këto dënime me burgim nuk do të ekzekutohen nëse të akuzuarit në afat prej 1 (një) viti pas plotfuqishmërisë se ketij aktgjykimi nuk kryejnë tjera vepra penale. Të akuzuarve S.P., D.S.

dhe Ç.L., iu është shqiptuar dënimi me gjobe secilit veç e veç në shumë prej nga 500 (pesëqind) euro e te cilat gjoba janë te obliguar që t'i paguajnë në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe dënimet me burgim secilit veç e veç në kohëzgjatje prej nga 10 (dhjetë) muaj me kusht se këto dënime me burgim nuk do të ekzekutohen nëse të akuzuarit në afat prej 2 (dy) vite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryejnë tjera vepra penale. Të gjithë të akuzuarve në dënimet e shqiptuara me burgim të kushtëzuar në rast të revokimit të të njëjtit do të iu llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim nga data 08.04.2022 deri me datë 10.04.2022.

Nëse të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin me gjobe, i njëjti do t'iu zëvendësohet në dënim me burgim ku për çdo 20 euro të gjobës do të iu llogaritet një ditë burgim.

Të akuzuarit janë obliguar që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, paushallin gjyqësor secili veç e veç në shumë prej nga 20 (njëzet) euro, dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit secili veç veç shumen prej nga 20 (njëzet) euro, e të gjitha këto në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykitimit.

Ndaj të akuzuarve është shqiptuar edhe dënimi plotësues konfiskimi i parave dhe mallrave më afër të precizuara në faqen 7, 8, 9, 10 dhe 11 si në aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkalles së parë.

#### **Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :**

Mbrojtësi i të akuzuarit me autorizim në fazën ankimore Ç.L., av. Kemajl Ademaj nga Ferizaji, lidhur me shkeljen e ligjit penal dhe pjesën që ka të bëjë me konfiskimin e mallrave dhe mjeteve financiare, sanksionin penal dhe vendimin për pagesën e shpenzimeve gjyqësore dhe paushallit gjyqësor, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkalles së parë të ndryshohet, dhe të akuzuarit të i kthehen mjetet financiare – paratë e konfiskuara si dhe mallrat e konfiskuara, të i shqiptohet një dënim më i ulët se sa dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkalles së parë, apo që aktgjykimi i shkalles së parë të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Prokurori i Apelit të Kosovës, duke u skjaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit Ç.L., av. Kemajl Ademaj, me shkresën e vet PPA.II.nr. 1165/23 të datës 14.09.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit të Kosovës, ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me nenin 390 paragrafi 1 të KPPRK-se, në të cilën nuk i ftoi palët ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me dënim me gjobë dhe burgim të kushtëzuar, andaj prezenca e palëve nuk është e obliguar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësit së të akuzuarit Ç.L., dhe gjeti se:

- **Ankesa nuk është e bazuar.**

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale mbrojtësi i të akuzuarit Ç.L., me ankese pretendon se aktgjykimi shkalles së parë është i perfshire me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 pika 1.12 e

lidhur me nenin 369 par.6 dhe par.7 të KPPRK-së. Sipas mbrojtësit së të akuzuarit aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmbanë arsye lidhur me faktet vendimtare sidomos lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore.

Gjykata e Apelit e Kosoves, vleresoi pretendimet ankimore të mbrojtësi së të akuzuarit Ç.L., lidhur me shkeljet esenciale te dispozitave te procedurës penale dhe konstatoi se te njëjtat nuk janë te bazuara ngase aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare eshte i qarte dhe i kuptueshem dhe si i tille përmban arsye te mjaftueshme përkitazi me faktet relevante te kësaj çeshtje juridiko penale si lidhur me vendimin mbi konfiskimin e parave dhe mallrave poashtu edhe lidhur me sanksionin penal, andaj pretendimet ankimore lidhur me shkeljet esenciale te dispozitave te procedurës penale i refuzoi si te pabazuara.

Gjendja faktike nuk ka qenë objekt shqyrtimi ngase i akuzuari Ç.L., gjatë shqyrtimit fillestar të datës 15.05.2023 në bazë të nenit 242 të KPPRK-së ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet që përmban aktakuza dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike del që në rastin konkret drejtë është aplikuar edhe ligji penal.

Sa i përket pretendimeve ankimore të mbrojtësit së të akuzuarit Ç.L., lidhur me shkeljen e ligjit penal me ankese i njëjti pretendon se gjykata e shkalles se pare kur ka vendosur qe t'i konfiskohen mjetet financiare – paratë si dhe mallrat, nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore dhe se nuk është dashur qe të njëjtit t'i konfiskohen paratë dhe mallrat dhe se aktgjykimi i shkalles se pare do te duhej te përmbante arsyetimin nëse Prokurori i Shtetit ka vërtetuar se çdo send nga pasuria e përshkruar ne aktakuzë edhe fituar me vepër penale, pra, sipas mbrojtësit aktgjykimi nuk është arsyetuar lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore, pra është përpiluar edhe ne kundërshtim me nenin 369 par.6 dhe par.7 të KPPRK-së.

Gjykata e Apelit pas vlerësimit te pretendimeve ankimore te mbrojtësit së të akuzuarit lidhur me shkeljen e ligjit penal në dëm të të akuzuarit konstatoi se të njëjta nuk janë të bazuara ngase i akuzuari edhe ne shqyrtimin fillestar pas leximit të aktakuzës i njëjti e ka pranuar fajësinë per veprën penale per te cilën është akuzuar në të gjitha pikat e aktakuzës e kjo shihet edhe nga procesverbali i shqyrtimit fillestar të datës 18.05.2022 dhe se i njëjti ka deklaruar se mbrojtjen do ta paraqes vet.

Neni 92 par.1 i KPRK-së dhe neni 269 par.1 dhe 270 të KPPRK-së parasheh se pas dënimit te te pandehurit per vepër penale, gjykata konfiskon të gjitha pasuritë e specifikuar te përcaktuara ne aktakuzë e cila pasuri ose mjeti është përfituar me vepër penale, e qe ne rastin konkret gjykata e shkalles se pare drejtë ka vepruar kur ka vendosur urdhëruar konfiskimin ngase i akuzuari nuk ka arsyetuar prejardhjen e mjeteve financiare dhe mallrave qe janë gjendur tek ai, andaj pretendimet ankimore te mbrojtësit së të akuzuarit, Gjykata e Apelit i refuzoi si te pabazuara duke e vërtetuar ne tërësi aktgjykimin e ankimuar te gjykatës se shkalles se pare.

Duke i patur parasysh rrethanat e cekura më lartë dhe rrethanat e rastit konkret Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë dhe me burgim të kushtëzuar drejte dhe ne mënyre te plote i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese nga neni 69 dhe 70 te KPRK-se te cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, andaj konstaton se dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve nga gjykata e

shkallës së parë janë në harmoni me shkallën e përgjegjesisë penale së të akuzuarve dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale të kryera, andaj e refuzoi si te pabazuar ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit Ç.L., e me bindje se me dënimet e shqiptuara nga ana e Gjykatës se shkalles se pare si lidhur me sanksionin penal ashtu edhe me konfiskimin e parave dhe mallrave, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tyre, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.1129/23 më 08.01.2024**

**Procesmbajtësi**  
**Arben Arifi**

---

**Anëtarët e kolegjit**  
**Abdullah Ahmeti**

---

**Kryetar i kolegjit**  
**Skender Çoçaj**

---

**Zyhdi Haziri**

---